

C.nr.53/2016

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidemi, në çështjen juridike të paditëses . (...) me seli në Prishtinë” (...), ndaj të paditurit N. (...) C. nga fshati P., Komuna..., me bazë juridike rimbursimitin e dëmit, jashtë seancës më datë: 03 Tetor 2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes)

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditëses B... me seli në P..., si e bazuar dhe **Obligohet** i padituri N. C. nga fshati P..., që paditëses të i’ a kompensoj shumë prej 395.00 €, (treqindë e nëntëdhjetë e pesë euro) në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të ndodhur më datë: 08 Dhjetor 2012, në Gjilan, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Obligohet i padituri që ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20 €.

A r s y e t i m

Paditësja, B...me seli në P....në këtë gjykatë më datë..., ka paraqitur padi ndaj të paditurit N.C. nga fshati P., K.P., për rimbursimitin e dëmit në vlerë prej 395.00 €, për dëmin e shkaktuar me automjet të dëmtuarit B.H.nga D..., në aksidentin e trafikut të ndodhur më datën ..., me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në ditën e pagesës përfundimtare në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që njëjti të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e tij, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurin, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë-mosbindjes. I padituri edhe pse e ka pranuar aktvendimin për përgjigje, të njëjtës nuk është përgjigjur fare, nga fletëkthesa e ekspeduesve me dt: ..., është konstatuar se i padituri N.C. e ka pranuar aktvendimin për përgjegje në padi të dt:...

Ndërkaq në padi përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar që i padituri N. C., më datë ..., rreth orës 22:30min, në Gj..., me automjetin e llojit “...” me targa të regjistrimit ... kishte shkaktuar aksident trafiku , me ç’rast I kishte shkaktuar dëme në automjetin e llojit “...”, me targa ..., pronar tani të dëmtuarit B.H.. Në këtë rast automjeti i të paditurit në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat te skaduar të policës së sigurimit. I dëmtuari në këtë aksident B. H., ka bërë kërkesë për kompensimitin e dëmit, sipas Ligjit për Sigurimitin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia të Republikës së Kosovës, në ...- Komisioni për vlerësimin e dëmeve, i ka kompenzuar dëmin material dhe jomaterial të pësuar si rezultat i aksidentit në shumë prej 395.00 €.

Paditësi së bashku me padi, gjykatës ia ka prezantuar këto prova materiale:

-Dosjen e dëmit nga Fondi i Kompensimit nr.2275/12, të datës 13.12.2012,

-Shkresa e ..., adresuar Bankës Ekonomike – fondi i kompensimit, mbi transferimin e mjeteve për dëmin, ne tabelën e së cilës figuron emri i të dëmtuarit B. H. në shumën prej 395.00 €, e datës 16.01.2013.

- Ujdia jashtëgjyqësore me numër të lëndës ... e lidhur më datën ... në P., në mes të B... dhe të dëmtuarit B. H.,

-Vendimi i BKS-së, ..., i datës 26.12.2012, me të cilën është miratuar kërkesa e të dëmtuarit B. H., lidhur me kompensimin e dëmit në automjet të pësuar nga aksidenti në trafik të ndodhur më datë ...

- Vendimi i Komisionit të Shkallës së Parë për Trajtimin e Dëmeve, ... i datës 26.12.2012, i B....-Departamenti i Fondeve të Kompensimeve,

- Aktvlerësimi i dëmit ne emer të B. H. i dt: ...

- Procesverbali mbi dëmtimin e automjetit te demtuarit B. H. i dt:.....,

- Fotografit e automjetit të të demtuarit Brahim Hajdini,

- Paraqitja e dëmit e dt ...

- Konfirmimi i Sigurimit: TPL..., i dt:....,

Gjykata duke u bazuar në nenin 253 parag 5, ka obliguar paditësen B..., që në afat prej 15 ditësh ta paguaj taksën gjyqësoren në shumë prej 20 €, gjykata me dt:..., ka pranuar një kopje të pagesës së taksës gjyqësore, andaj edhe ka vendosur si në piket II, të këtij aktgjykimi.

Meqë i padituri N. C., në afatin e caktuar me ligj në gjykatë nuk ka paraqitur përgjigje në padi , gjykata duke u mbështetur në neni 150 paragrafi 1 pika (a) (b) dhe (c) lidhur me nenin 388 të LPK-së, mori aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes) si në dipozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Më datë 03 Tetor 2017

Gjyqtarja

Mirvete Alidemi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nëpërmjet kësaj gjykate.